

VENDIM
Nr.89, datë 28.1.2008

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË SIPËRFAQES 470,8 M²,
PJESË E PRONËS NR.180 “BATALIONI I POLICISË USHTARAKE”, SAUK, TIRANË,
NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE,
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja 470,8 m², në pronën nr.180 “Batalioni i Policisë Ushtarake”, reparti ushtarak nr.4002, Sauk, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes të kalojë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, për t’u përdorur për rehabilitimin e rrugës Sauk, Tiranë.

2. Kjo sipërfaqe, sipas genplanit, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit i ndalohet t’i ndryshojë destinacionin pronës së përcaktuar në këtë vendim.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Policia Ushtarake

Rilevim i territorit te P.U ae do te vihjet ne dispozicion te rruges nacionale

- Aks i rruges
- Kufiri i rruges
- Kufiri i rep

Siperfaqja e pergjithshme(S1+S2) 470.875 m²



Shenimi: Kufiri i rruges ne pjesen e reparimit
eshte hedhur ne baze te pikave te
fiksuar nga zbatuesit e projektit.

